

1 E diel, 8 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari Thaçi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve
7 dhe mirë se keni ardhur në këtë Paraqitje të Parë.

8 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni
12 Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.
14 Sekretare.

15 Përpara sesa të fillojmë dua që t'i jap mundësi
16 fotografit që të bëjë disa fotografi. Ju lutem mund të
17 vazhdoni. Keni një minutë e gjysmë që të bëni fotografi. Mesa
18 kuptoj unë z. Thaçi nuk dëshiron që të paraqitet nga afër në
19 fotografi, apo jo.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, është e saktë kjo.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Atëherë ju lutem vazhdoni
22 në këtë mënyrë, Fotografe.

23 Faleminderit, zonja Fotografe.

24 Përpara sesa t'u kërkoj palëve që janë të pranishëm në
25 sallë që të prezantohen, dua që t'ju kujtoj të gjithëve për

1 rregullat që duhet të respektohen gjatë të gjithë kohës, në
2 mënyrë të tillë që të realizohet mbarëvajtja e procedurave.

3 Ju lutem sigurohuni që të keni ndezur mikrofonin përpara
4 sesa të flisni dhe që ta fikni sapo të keni përfunduar së
5 folur. Flisni ngadalë dhe qartë pasi seanca po përkthehet nga
6 shqipja drejt shqipes dhe në serbisht. Bëni një pauzë prej
7 pesë sekondash përpara se të jepni përgjigje ndaj pyetjeve të
8 mia ose të një pale tjetër në mënyrë të tillë që t'i lejoni
9 përkthyesve që të përfundojnë me përkthimin e tyre.

10 Dua gjithashtu që t'ju kujtoj që informacioni i caktuar
11 në këtë çështje është objekt konfidencialiteti. Informacioni
12 konfidencial nuk duhet të nxirret në seancë të hapur. Në qoftë
13 se ndonjëra nga palët dëshiron që t'i drejtohet ose të
14 diskutojë informacion konfidencial ju lutem na e bëni me dije
15 këtë gjë për të kaluar në seancë private.

16 Tani do ju kërkoja palëve që të prezantohen, duke filluar
17 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,
19 unë jam Joshua Hafetz, në emër të ZPS-së dhe bashkë me mua
20 është edhe Prokuroria e Specializuar Kim West që është ulur
21 pas meje. Gjithashtu në të majtën time është Gaia Pergolo, dhe
22 Line Pedersen.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani Mbrojtja.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

1 Gjykatës. Unë jam Nina Tavakoli, jam avokate e z. Thaçi dhe
2 sot asistohem ose ndihmohem nga Lirim Greicevci.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

4 Për procesverbal vërej që klienti juaj z. Thaçi po ashtu
5 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

6 Tani do t'i kaloj Zyrës Administrative fjalën.

7 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
8 Mirëmëngjes, kolegë. Unë jam Jonas Nilsson, jam
9 Zëvendësadministratori. Jam këtu së bashku me Whitney Price,
10 që është eksperte ligjore. Faleminderit.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

12 Dhe së fundi për procesverbal, unë jam Majorie Masselot,
13 jam Gjykatëse e Procedurës Paraprake.

14 I akuzuari del për herë të parë përpara Dhomave të
15 Specializuara pas lëshimit të aktakuzës së ngritur kundër tij
16 me datë 29 nëntor 2024.

17 Z. Thaçi, ju lutem a mund të ngriheni në këmbë. Ju lutem
18 a mund të thoni emrin e plotë për procesverbal.

19 Ndizeni mikrofonin që keni përpara z. Thaçi.

20 Faleminderit.

21 I AKUZUARI THAÇI: Hashim Thaçi.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Datëlindja dhe vendlindja
23 juaj?

24 I AKUZUARI THAÇI: 24 prill 1968.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Çfarë shtetësie keni? Një

1 ose disa në qoftë se keni disa.

2 I AKUZUARI THAÇI: Shtetas i Kosovës

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Çfarë profesioni keni?

4 I AKUZUARI THAÇI: *[Në anglisht] Politician.*

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Z. Thaçi, përpara se të

6 vazhdojmë më tej, më duhet që të sigurohem që ju e ndiqni

7 procesin gjyqësor në një gjuhë që e kuptoni dhe e flisni. A

8 mund të konfirmoni që ju e kuptoni dhe e flisni shqipen.

9 I AKUZUARI THAÇI: Po

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.

11 Me këtë jam e bindur që ju mund të ndiqni procedurën në shqip,

12 një gjuhë që ju e kuptoni dhe e flisni në pajtim me rregullën

13 92 të Rregullores së Procedurave dhe të Provave.

14 Në qoftë se në ndonjë çast gjatë procesit gjyqësor nuk

15 merrni përkthim, ju lutem, na e vini përnjëherë në dijeni këtë

16 gjë.

17 Z. Thaçi, fikeni mikrofonin nëse është e mundur.

18 Tani do jap një historik të shkurtër procedural për të

19 prezantuar seancën e sotme, Paraqitjen e Parë.

20 Me datë 29 nëntor 2024, në cilësinë time si Gjykatëse e

21 Procedurës Paraprake unë kam konfirmuar pjesërisht aktakuzën e

22 dorëzuar nga Prokurori i Specializuar kundër zotërinjve Hashim

23 Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin

24 Kuçi, duke e akuzuar z. Thaçi me tre pika për tentativë për

25 pengimin e personave zyrtarë për të kryer detyrat zyrtare

1 përmes pjesëmarrjes së veprimeve të përbashkëta në një grup;
2 katër pika që lidhen me shkelje të fshehtësisë së procedurave;
3 dhe katër pika për mosbindje ndaj Gjykatës.

4 Gjithashtu kam lëshuar një fletë-arresti për z. Thaçi të
5 njëjtën ditë.

6 Me datë 5 dhjetor 2024, Administratorja i dorëzoi z.
7 Thaçi në njësinë e paraburgimit në Dhomat e Specializuara në
8 Hagë, fletë-arrestin, Aktakuzën e Konfirmuar si dhe vendimin
9 mbi fletë-arrestin e tij të përkthyer në shqip.

10 Më 6 dhjetor 2024, unë lëshova një vendim për përcaktimin
11 e datës së sotme për Paraqitjen e Parë.

12 Tani më lejoni që të them se cilat janë qëllimet konkrete
13 për këtë Paraqitje të Parë për z. Thaçin.

14 Seanca e ditës së sotme, z. Thaçi, nuk është gjykim. Në
15 këtë seancë nuk do të paraqitet asnjë provë dhe nuk do të
16 debatohet dhe gjithashtu nuk diskutohet për fajësinë ose
17 pafajësinë e atë akuzuarit.

18 Qëllimi i kësaj seancë i Paraqitjes së Parë parashikohet
19 nga neni 39(5) i Ligjit, dhe rregulla 92 e Rregullores. Në
20 pajtim me këto dispozita, si Gjykatëse e Procedurës Paraprake
21 unë:

22 Do t'ju lexoj akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar për ju,
23 për të akuzuarin;

24 Do të konfirmoj që i akuzuari e kupton aktakuzën;

25 Do të bindem që të drejtat e të akuzuarit, në veçanti e

1 drejta e tij për të pasur avokat mbrojtës, janë respektuar;

2 Do të informoj të akuzuarin që brenda 30 ditëve nga
3 seanca e sotme ai -- atij do t'i drejtohem për të pranuar ose
4 jo fajësinë për secilën prej pikave të cilat janë të shkruara
5 në aktakuzë. Në qoftë se i akuzuari dëshiron ta bëjë këtë gjë,
6 ai menjëherë mund të pranojë fajësinë ose pafajësinë.

7 Së fundi, unë do të caktoj data të tjera sipas nevojës të
8 cilat janë të nevojshme për realizimin e funksioneve të mia si
9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

10 Këto janë çështjet të cilat unë do të trajtoj gjatë
11 Paraqitjes së Parë. Në qoftë se ndonjëra nga palët dëshiron që
12 të diskutojë një çështje tjetër që nuk parashikohet
13 shprehimisht në kuadrin e paraqitjes paraprake, Paraqitjes së
14 Parë, do ju ftoj që ta bëni këtë përmes një parashtrimi
15 protokolluar.

16 Së pari, ngrihuni në këmbë z. Thaçi.

17 A mund t'ju kërkoj që të konfirmoni që e keni marrë
18 Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë që ju e kuptoni dhe e
19 flisni, z. Thaçi?

20 I AKUZUARI THAÇI: Po.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.

22 Z. Thaçi, përpara se Sekretarja e seancës sot do ju
23 lexojë Akuzat e Konfirmuara, dua t'ju kujtoj që kjo nuk është
24 koha që të kontestoni ose kundërshtoni aktakuzat, po thjesht
25 të na thoni në qoftë se i kuptoni apo jo. Do të keni mundësi

1 që të kundërshtoni akuzat me ndihmën e avokates tuaj.

2 Tani do i kërkoj znj. Sekretare që të lexojë akuzat në
3 Aktakuzën e Konfirmuar ,sikurse parashikohet në nenin 39(5) të
4 Ligjit dhe rregullën 92(2) (b) e Rregullores.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
6 Gjykatëse.

7 Në Aktakuzën e Konfirmuar Prokurori i Specializuar e
8 akuzon z. Thaçi me:

9 Pikat 1 deri në 3: Përpjekje për të penguar personat
10 zyrtarë, si prokurorë dhe hetues, duke vepruar në tri grupe të
11 ndara dhe gjithashtu dhe si drejtues ose organizator i këtyre
12 grupeve, që janë të ndëshkueshme sipas nenit 401(2), (3) dhe
13 (5) i Kodit Penal të Kosovë dhe nenit 15(2) të Ligjit;

14 Pikat 4 deri në 6: Shkelje e fshehtësisë së procedurës
15 përmes nxjerrjes së paautorizuar të informacionit sekret, që
16 është i ndëshkueshëm sipas nenit 392(1) i Kodit Penal të
17 Kosovës të vitit 2019 dhe nenit 15(2) i Ligjit;

18 Pika 7: Shkelje e sekretit të procedurave -- e
19 fshehtësisë së procedurave përmes nxjerrjes së paautorizuar të
20 identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur, që është e
21 ndëshkueshme sipas nenit 392(2) i Kodit Penal të Kosovës të
22 vitit 2019 dhe nenit 15(2) i Ligjit;

23 Dhe Pikat 8 deri në 11: Mosbindje ndaj gjykatës, që është
24 e ndëshkueshme sipas nenit 293 të Kodit Penal të Kosovës të
25 vitit 2019 dhe nenit 15(2) i Ligjit.

1 2. Këto vepra penale janë kryer në periudhën nga të
2 paktën 26 qershori dhe 2 nëntori i vitit 2023.

3 3. Në lidhje me këto vepra ekziston dyshimi i mirëbazuar
4 që z. Hashim Thaçi mban përgjegjësi penale në përputhje me
5 nenin 16(3) i Ligjit për:

6 a. Kryerjen e veprave për përpjekje për pengimin e
7 personave zyrtarë për kryerjen e detyrave zyrtare duke shkelur
8 fshehtësinë e procedurave dhe kundërshtimin ndaj Gjykatës,
9 mosbindjen ndaj Gjykatës sipas Pikave 1 deri në 8 dhe pikave
10 10 deri në 11, në pajtim me nenin 17 të Kodit Penal të Kosovës
11 të vitit 2019;

12 b. Nxitje ndaj z. Bashkim Smakaj, Isni Kilajt dhe z.
13 Fadil Fazliu për të kryer veprat e përpjekjeve për pengimin e
14 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare në kuadrin e
15 grupeve përkatëse nën Pikat 1 deri në 3, në pajtim me nenin
16 32(1) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;

17 c. Marrëveshje për të kryer së bashku me z. Bashkim
18 Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu, në kontekst të grupeve
19 të tyre përkatëse, të tentativës për të penguar personat
20 zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas Pikave 1 deri në
21 3, në pajtim me nenin 35 të Kodit Penal të Kosovës të 2019-s;
22 dhe

23 d. Pajtimin për të kryer me z. Hajredin Kuçi veprën e
24 mosbindjes ndaj Gjykatës sipas Pikës 9, në pajtim me nenin 35
25 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

1 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

3 Sekretare.

4 Z. Thaçi, a i kuptuat aktakuzat që përmban Aktakuza e
5 Konfirmuar sikurse iu lexua nga Sekretarja e seancës?

6 I AKUZUARI THAÇI: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

8 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja ju
9 garantojnë juve, z. Thaçi, disa të drejta. Do t'ju lexoj të
10 drejtat më të rëndësishme, në veçanti ato të drejta të cilat
11 kanë të bëjnë me këtë fazë të procesit.

12 Ju prezumoheni i pafajshëm derisa të provohet që jeni i
13 fajshëm përtej dyshimit të arsyeshëm.

14 Në përcaktimin e akuzave ndaj jush, keni të drejtë që t'i
15 nënshtroheni një seance të drejtë dhe publike, në varësi të
16 masave të cilat janë urdhëruar për mbrojtjen e viktimave dhe
17 dëshmitarëve.

18 Keni të drejtën që të informoheni menjëherë dhe në
19 hollësi në një gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe shkakun e
20 akuzave të ngritura kundër jush.

21 Keni të drejtën që të keni kohë dhe mjete të mjaftueshme
22 për përgatitjen e Mbrojtjes për të komunikuar me një avokat
23 për përzgjedhur prej jush.

24 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
25 arsyeshme.

1 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe për ta
2 mbrojtur veten përmes avokatit.

3 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat dhe pa pagesë
4 në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar për
5 avokatin.

6 Keni të drejtën që të merrni ndihmë pa pagesë nga një
7 përkthyer në qoftë se nuk e kuptoni ose nuk e flisni gjuhën që
8 përdoret në Gjykatë.

9 Keni të drejtën që të mos detyroheni që të dëshmoni
10 kundër vetes ose të pranoni fajësinë.

11 Keni të drejtën për të mos folur dhe nuk do të nxirret
12 asnjë nënkuptim negativ sa i takon të drejtës tuaj për të mos
13 folur.

14 Keni të drejtën që të mos ndaloheni për një periudhë të
15 paarsyeshme kohe përpara hapjes së çështjes, të kërkonit
16 rishikim të vendimeve për ndalimin tuaj dhe për t'i apeluar
17 vendime të tilla drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës së Apelit.

18 Z. Thaçi, unë sapo ju lexova të drejtat më të rëndësishme
19 që ju gëzoni në pajtim me kuadrin ligjor të zbatueshëm të
20 Dhomave të Specializuara.

21 A i kuptoni këto të drejtat, z. Thaçi?

22 I AKUZUARI THAÇI: Po.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.

24 Po ashtu dëshiroj t'ju informoj që në pajtim me nenin
25 21(5) i Ligjit, ju nuk mund ta përfaqësoni veten sepse

1 aktualisht jeni në paraburgim. Përfaqësimi nga Mbrojtësi i
2 Specializuar si rezultat është i domosdoshëm, është i
3 detyrueshëm.

4 Për procesverbal unë po them që ju jeni i përfaqësuar nga
5 znj. Tavakoli, kështu që unë jam e bindur që i akuzuari tani
6 është i përfaqësuar nga një avokat.

7 Tani dua që t'i drejtohem të drejtave të të akuzuarit për
8 t'u shprehur sa i takon rregullës 92 të Rregullores për t'u
9 vetëdeklaruar jofajtor apo jo.

10 Z. Thaçi, brenda 30 ditëve nga dita e sotme juve do ju
11 drejtohem për të pranuar fajësinë ose pafajësinë sa i takon
12 akuzave të aktakuzës. Në qoftë se dëshironi mund të
13 deklaroheni menjëherë sa i takon fajësisë ose pafajësisë tuaj.
14 Dua që t'ju pyes tani, z. Thaçi, në qoftë se keni pasur
15 mundësi që t'i diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me
16 avokaten tuaj dhe në qoftë se jeni të përgatitur që të
17 deklaroheni tani.

18 I AKUZUARI THAÇI: E nderuara Gjyqtare, të nderuar të
19 gjithë të pranishëm, me siguri ju e dini se unë tash e katër
20 vite përballëm me një proces tjetër gjyqësor dhe kemi dëgjuar
21 vlerësime keqinterpretuese të historisë politike dhe kombëtare
22 për lirinë, shtetin dhe pavarësinë e Kosovës, më së paku nga
23 vitet nga vitet 1980 deri më sot. Pra, është një proces
24 voluminoz. E di se shoqëria kosovare, familja ime dhe unë
25 presim me padurim fundin e këtij procesi, presim drejtësi, për

1 ç'ka dhe besojmë në drejtësi.

2 Krejt papritmas, para dy-tre ditësh, u njoftova për
3 akuzën e re nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. E di se
4 Kosova është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme elektorale,
5 por unë nuk jam pjesë e garës elektorale. Unë nuk paraqes
6 rrezik politik për askënd. Prandaj, kërkoj edhe sot, unë besoj
7 dhe respektoj Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kërkoj edhe
8 sot nga të gjithë kudo që jemi ulur në secilëndo anë, apo me
9 çdo formë që jemi, në këtë sallë, të respektohet Kushtetua dhe
10 ligjet e Kosovës sepse Dhomat e Specializuara janë produkt i
11 institucioneve të Republikës së Kosovës.

12 Unë nuk kam pasur mundësi për shkak të angazhimeve të
13 tjera që të diskutoj në thelb dokumentin e konfirmuar nga ana
14 juaj, prandaj do të deklarojem me kohë brenda afatit të
15 rregullt kushtetues dhe ligjor. Ju faleminderit.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Atëherë nuk ka
17 vetëdeklarim sot. Faleminderit, z. Thaçi.

18 Sapo më informuan që ju iu përgjigjët pyetjes në qoftë se
19 i kuptoni apo jo -- nuk i jeni përgjigjur pyetjes në qoftë se
20 i kuptoni apo jo akuzat e ngritura ndaj jush. Është e
21 rëndësishme që të flisni përpara mikrofonit, në mënyrë të
22 tillë që të regjistrohet në procesverbal.

23 Kështu që do ju lutesha ta përsërisnit edhe një herë
24 përgjigjen që kishit ndaj kësaj pyetjes. Domethënë, A i
25 kuptoni apo jo akuzat e ngrita kundër jush. Kjo është pyetja.

1 I AKUZUARI THAÇI: Ende s'i kam lexuar në tërësi, prandaj
2 duhet me i lexu për me i kuptu.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] A dëshironi të bëni një
4 pushim që të mund t'i lexoni?

5 I AKUZUARI THAÇI: Jo, nuk ka nevojë. Nuk ka nevojë.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokate?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndoshta duhet t'i jap disa
8 udhëzime klientit.

9 [Avokatja e Specializuar këshillohet]

10 [Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe

11 Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se do mundemi do ishte
13 mirë që bëjmë një pushim të shkurtër. Do e vlerësonim shumë.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Do bëjmë një
15 pushim prej 10 minutash. Ju mjaftojnë 10 minuta?

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
17 Gjykatëse

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Do bëjmë 10
19 minuta pushim dhe do rifillojmë përsëri në orën 10.00.

20 --- Seanca ndërpritet në orën 09.51

21 --- Seanca rifillon në orën 09.58

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Rifillojmë seancën.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Konfirmojmë se jemi në
24 seancë të hapur.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Thaçi, bëme një pushim që t'ju jepnim ju mundësinë të
2 diskutonit me avokaten tuaj lidhur me pyetjet. Pra, pyetja
3 ishte: A i kuptoni akuzat që ua lexoi Sekretarja e seancës në
4 fillim sot. Nëse nuk e kam gabim, ju u përgjigjët që e kuptuat
5 në ato momente dhe unë ua përsërita pyetjen sepse nuk ishte
6 mikrofoni i ndezur dhe kjo nuk u pasqyrua në procesverbal, por
7 kur ju pyeta sërish ju na dhatë një përgjigje tjetër.

8 Ju lutem a mund të përgjigjeni tani lidhur me këtë pyetje
9 çfarë qëndrimi keni?

10 I AKUZUARI THAÇI: E kam kuptuar.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 [Përkthim] Faleminderit. Në rregull.

13 Duke marrë parasysh se z. Thaçi nuk është vetëdeklaruar
14 për momentin, u kërkoj palëve të na japin parashtrimet e tyre
15 paraprake lidhur me seancën e radhës për vetëdeklarimin.

16 Dua ta bëj të qartë që kjo seancë duhet të mbahet brenda
17 30 ditësh duke filluar nga dita e sotme, që i takon data 7
18 janar 2025 dhe mesa kuptoj unë kjo i bie brenda periudhës së
19 pushimeve të Gjykatës.

20 A keni ndonjë parashtrim lidhur me këtë? Fillojmë me
21 Mbrojtjen e z. Thaçi. Fjala është për ju.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mbrojtja është gati të vijë dhe
23 në 7 janar në mënyrë që z. Thaçi të vetëdeklarohet.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

25 Prokurori?

1 Z. HAFETZ: [Përkthim] Dhe ne jemi në çdo moment të
2 disponueshëm që të mbajmë seancën lidhur me vetëdeklarimin.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Do ta
4 caktojmë datën në kohën e duhur.

5 Tani flasim për gjuhën e punës së procesit gjyqësor. Në
6 vendimin paraprak ftova palët që të japin parashtimet e veta
7 lidhur me seancën e sotme lidhur me gjuhën që do të përdoret
8 në këtë lëndë gjyqësore në bazë të rregullës 8(3) të
9 Rregullores.

10 Palët a mund të shprehin parapëlqimin e tyre.

11 Fillojmë me Prokurorin.

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne parapëlqejmë që gjuha të jetë
13 anglishtja.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E marr parasysh.

15 Mbrojtja?

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Edhe për ne anglishtja është
17 gjuha e punës.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Do të lëshoj
19 një vendim lidhur me këtë në kohën e duhur.

20 Në vendimin ku do të caktoj -- në vendimin ku caktova
21 datën e seancës së sotme, po ashtu bëra me dije se do të kemi
22 një konferencë për ecurinë e çështjes për këtë lëndë
23 gjyqësore, në bazë të rregullës 96 të Rregullores brenda datës
24 17 dhjetor, e martë, 2024, në orën 2.00. Ju kam kërkuar të
25 bëni parashtimet tuaja lidhur me këtë nëse dëshironi të

1 merrni pjesë në konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore
2 personalisht apo përmes videolidhjes.

3 Avokate, fjala është për ju.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mesa keni ju dijeni unë jam
5 bashkëmbrojtëse në Lëndën 06 edhe ajo çështje për këtë vit
6 përfundoi të premtën. Po për shkak se jemi njoftuar shumë vonë
7 lidhur me këtë seancë, unë nuk jam e lirë për datën që
8 propozoni ju. Pra data që propozuat ju ishte data 17 dhjetor.

9 Data më e parë që mund të jem unë e lirë është data 17
10 janar.

11 Megjithatë, kini parasysh që z. Thaçit do t'i duhet t'i
12 caktohet një avokat tjetër i cili mund të marrë pjesë përmes
13 videolidhjes dhe ky avokat do të jetë Luka Misetić.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. E marrim
15 parasysh.

16 Prokurori i Specializuar?

17 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne mund të jemi personalisht të
18 pranishëm në datën që propozoni ju.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

20 Do caktojmë datën në afatin e duhur ku do të kemi dhe
21 rendin e ditës. Dhe në atë urdhër do të japim dhe instruksione
22 lidhur me detyrimet për pjesëmarrjen në këtë konferencë përmes
23 videolidhjes.

24 Tani sa i takon paraburgimit tuaj, Z. Thaçi.

25 Rikujtoj se bazuar në konstatimet e mirëbazuara se keni

1 kryer veprat penale që sapo ju lexuam është lëshuar një fletë-
2 arrest kundër jush më 20 nëntor 2024. Në bazë të nenit
3 41(6)(b) i Ligjit, arrestimi juaj u gjykua i domosdoshëm
4 bazuar në ekzistencën e arsyeve të besueshme se ju jeni rrezik
5 arratisje, mund të pengoni ecurinë e procesit gjyqësor dhe
6 mund të përsërisni veprat penale që u përmendën më herët.

7 Gjithashtu përsëris se përveç arrestimit ju është dhënë
8 një vendim mbi kërkesën për fletë-arrestin dhe çështjet në
9 lidhje me të, i përkthyer në shqip bashkë me Aktakuzën e
10 Konfirmuar.

11 Tani do të doja të dija prej Mbrojtjes nëse ka ndonjë ka
12 ndonjë parashtrim lidhur me paraburgimin tuaj.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për shkak
14 se klienti im në fakt është në paraburgim në kuadër të Lëndës
15 06, kështu që i takon që kjo është e panevojshme. Sidoqoftë
16 duhet doja të thoja disa gjëra për procesverbal.

17 E kuptoj që ju keni marrë një vlerësim të pavarur, e keni
18 kryer një vlerësim të pavarur nëse ka arsye që, për shembull,
19 z. Thaçi është person që mund të arratiset, por do të doja të
20 thoja për procesverbal që Trupi Gjyqësor në Çështje 06
21 asnjëherë nuk e ka konsideruar z. Thaçi si person që mund të
22 arratiset. Ai është dorëzuar vullnetarisht në juridiksionin e
23 kësaj Gjykate edhe ka hequr dorë nga pozicioni i tij si
24 President për të qenë këtu edhe kjo është theksuar në Çështjen
25 06.

1 Mbrojtja gjithashtu vëren shqetësimin që ka lidhur me
2 konstatimet e Gjykatës Paraprake në kuadër të vendimit që ka
3 marrë, për shembull, në paragrafin 48, F00037 për lëndët, që
4 në fakt mbivendosen me çështjet në Çështjen 06, për shembull,
5 klienti im, roli që ka pasur në UÇK, që ka qenë një prej
6 themeluesve të UCK-së.

7 Ne jemi të shqetësuar sepse duket sikur ZPS-ja po
8 përpiqet të litigojë këtë çështje në të njëjtën kohë kur po
9 litigon edhe në Çështjen 06 kundër klientit tim. Kjo është
10 vërtet shumë shqetësuese aktualisht dhe duhet të keni parasysh
11 që nuk duhet të ketë mbivendosje të këtyre lëndëve gjyqësore.
12 Për shembull, konstatimi që keni marrë sa i takon një çështje
13 të drejtpërdrejtë në këtë proces gjyqësor, konstatimi juaj për
14 ne është problematik.

15 Pra mbrojtja e kupton së për faktin që z. Thaçi është në
16 paraburgim, aktualisht çdo kërkesë për lirim të përkohshëm
17 është tejkalluar në këtë fazë, sidoqoftë ky ishte konstatimi
18 ynë lidhur me qëndrimin tuaj.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] ZPS-ja ka diçka për të
20 thënë?

21 Faleminderit, znj. Tavakoli.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkurtimisht. Unë do mbështetem në
23 parashtrimet që kemi bërë tashmë për paraburgimin. Unë e
24 kuptoj që ju keni dalë me një vendim që ka numrin F00037 dhe
25 se ju duhet të bëni vlerësimin tuaj të pavarura lidhur me

1 paraburgimin për këtë lëndë gjyqësore. Njësoj si dhe lëndët e
2 tjera gjyqësore sikurse është dhe Lënda 06.

3 Do të doja të theksoja që të gjitha konstatimet që keni
4 bërë ju janë legjitime, sipas rregullës 41(6). Domethënë, e
5 para, ka dyshim të mirëbazuar, i konfirmuar tashmë në aktakuzë
6 dhe iu lexua z. Thaçi, se ka kryer disa vepra penale gjatë
7 kohës që ka qenë në paraburgim, ç'ka do të thotë që është
8 përmbushur pragu i parë i kësaj rregulle.

9 Gjithashtu sikurse thatë edhe ju, të tri faktorët të
10 gjitha janë alternative, të tri janë alternative për arsye për
11 vazhdimin e paraburgimit, konkretisht të tjera janë plotësuar,
12 (i), (ii), dhe (iii) të nenit 46(b).

13 Sa i takon arratisjes së klientit kjo është i
14 papërshtatshëm parashtrimi. Nuk mund të flasim tani nëse
15 aktualisht z. Thaçi është rrezik arratisje. Nuk është nevoja
16 ta diskutojmë këtu, po sidoqoftë z. Thaçi është person që
17 është rrezik arratisje.

18 Ai ka kryer vazhdimisht sjellje penguese ndaj drejtësisë.
19 Ai akuzohet, dhe është konfirmuar tashmë në aktakuzë, se ka
20 qenë drejtuesi i një praktike penguese, veçanërisht duke
21 shënjestruar disa dëshmitarë që janë pjesë e gjykimit të tij
22 të vazhdueshëm. Kjo nuk është e papritur. Z. Thaçi akuzohet
23 për ndërhyrje në lëndën e tij gjyqësore.

24 Dy faktorët e tjerë po ashtu janë përmbushur për arsyet
25 që ju, e nderuar Gjykatëse, i keni nxjerrë në vendimin tuaj.

1 Ai është një rrezik i konsiderueshëm sepse mund të kryejë
2 vepra të tjera penale në kuadër të procesit gjyqësor dhe mund
3 të kryejë krime të tjera në të ardhmen. Këtë e ka demonstruar
4 tashmë për më shumë se një vit, edhe ai tregon se mund të
5 kryejë vepra penale gjatë kohës që është në paraburgim, edhe
6 është rrezik më i madh nëse lirohet sepse do të thotë që do të
7 vijojë kryerjen e veprave penale, jo vetëm për këtë lëndë
8 gjyqësore, por edhe për lëndët e tjera gjyqësore.

9 Pra, të tri faktorët janë përmbushur dhe për rrjedhojë
10 është e nevojshme që të vijohet me paraburgimin e tij.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

12 Shoh avokaten. Avokatja Tavakoli, dëshironi ta merrni
13 sërish fjalën lidhur me këtë?

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, unë mendova që ky është
15 thjesht akademik, ky ushtrimi është krejt i panevojshëm.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Kjo u
17 pasqyrua në procesverbal.

18 Do qëndrojmë disa minuta në sallën e gjyqit ju lutem,
19 sepse do të nxjerr një vendim lidhur me paraburgimin për pak
20 minuta.

21 Në rregull. Do të jap urdhrin me gojë lidhur me
22 paraburgimin.

23 Mora parasysh parashtrimet e Prokurorit të Specializuar
24 ku u shpreh se z. Thaçi duhet të qëndrojë në paraburgim.

25 Avokate, znj. Avokate, e mora parasysh dhe qëndrimin -- dhe

1 parashtrimin tuaj, ç'ka do të thotë që ju nuk bëtë ndonjë
2 parashtrim të thelluar sot në lidhje me këtë duke marrë
3 parasysh që ju thoni që është thjesht teorike kjo që po bëni
4 ju.

5 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, unë vendos se
6 z. Thaçi duhet të qëndrojë në paraburgim. Arsyet për vijimin e
7 paraburgimit janë të njëjtat arsye që unë kam përcaktuar në
8 vendimin mbi fletë-arrestin dhe çështjet në lidhje me të, më
9 konkretisht të shprehura në paragrafët 43, dhe 45 si dhe 55 të
10 cilat do t'i lexohen bashkë me vendimin në fjalë.

11 Z. Thaçi, unë kam rishikuar arsyet për paraburgimin tuaj
12 brenda dy muajsh ose në një kohë më të hershme nëse ka
13 ndryshim të rrethanave të cilat janë të përcaktuara në nenin
14 41(10) të Ligjit dhe 57(2) të Rregullores.

15 E nderuar Avokate, nëse doni të bëni parashtrime për
16 paraburgimin, për rishikimin e paraburgimit, ju lutem, këto
17 parashtrime bëjini brenda të mërkurës, data 15 janar 2025. Do
18 të jepen përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve që janë
19 përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores.

20 Nëse Mbrojtja nuk do të bëjë parashtrime brenda afatit që
21 unë përmenda, atëherë unë urdhëroj ZPS-në të bëjë parashtrimet
22 e veta lidhur me rishikimin e radhës të paraburgimit të z.
23 Thaçi, brenda 21 janarit 2025.

24 Mbrojtja mund të përgjigjet, nëse dëshiron, jo më vonë se
25 të martën, 28 janar 2025.

1 Nuk do të shqyrtohen kundërpërgjigjet e mëtutjeshme.

2 Së fundi, z. Thaçi, ju keni të drejtë të apeloni vendimin
3 e sotshëm, lidhur me paraburgimin tuaj, përpara Trupit të
4 Panelit brenda 10 ditësh sipas parashikohet në nenin 45(2) të
5 Ligjit dhe rregullës 58 dhe 117 të Rregullores.

6 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

7 Aktualisht do të doja t'ju kërkoja palëve nëse duan të
8 shprehen lidhur me diçka tjetër për seancën e sotme.

9 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi gjë për të thënë.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kemi gjë për të thënë.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

12 Seanca e parë për z. Thaçi përfundon këtu. Falënderoj
13 palët, Zyrën Administrative për pjesëmarrjen, dhe sigurisht
14 falënderoj përkthyesit, stenografët dhe të gjithë personat e
15 tjerë për ndihmën e tyre.

16 Seanca mbyllet këtu.

17 --- Seanca e paraqitjes së parë mbyllet në orën

18 10.14

19

20

21

22

23

24

25